



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KLOS

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE

SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE **Sektori i MZSH-së**

PUNONJËS TË SHËRBIMIT TË MZSH-SË PËR NIVELIN BAZË TË SHËRBIMIT VENDOR TË MZSH-SË, SEKTORI I MZSH-SË BASHKIA KLOS

Në mbështetje dhe në zbatim të Ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, si dhe të VKM-së Nr.520, datë 25.7.2019 “Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, si dhe të Urdhrit nr.8, datë 19.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Bashkisë Klos”, Bashkia e Klos shpall procedurat e konkurrimit për vendet e lira :

- Personel zjarrfikës, (niveli bazë)

Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës

Shërbimi i MZSH-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, misioni i të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shurjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjës së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkatuara nga dora e njeriut. Zjarrfikësi është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të MZSH-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut, të gjës së gjallë dhe pronës. Duhet të njoh dhe te zbatoje orarin e veprimeve, të dijë pozicionin në shërbim dhe detyrat e tij funksionale, të jetë në çdo kohë në gadishmëri të lartë për të vepruar në zgjidhjen e situatave që ndodhin, të njoh dhe të zbatojë rregullat e brendshme në stacion dhe të sigurojë paprekshmërinë dhe abuzimin e mjedisëve, teknikës, paisjeve etj, të mbajë pastër të gjitha ambientet që disponon stacioni, të jetë i sjellshëm në komunikim me qytetarët që kërkojnë ndihmë, me kolegët duke pasqyruar një figurë qytetare dhe humane.

Kandidatët për punonjës zjarrfikës duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- ç) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;

- d) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- dh) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- e) Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë).
- ë) Të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç;
- f) Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës;
- g) Të jetë me vendbanim sa më pranë stacionit të MZSH-së;
- gj) Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm.
- h) Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) cm.
- i) Të jetë me peshë trupore që t'i përgjigjet raportit të gjatësisë.
- j) Të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të grupit "C";
- k) Kandidati për personelin drejtues automjeteve zjarrfikëse dhe shpëtimi në shërbimin e MZSH-së duhet të jetë i pajisur me leje drejtimi automjeti, grupi "D", si dhe me leje drejtimi të veçantë shërbimi, konform kërkesave të Kodit Rrugor. Kanë prioritet kandidatët që zotërojnë profesione si mekanik, shofer, hidraulik, marangoz, infermier etj.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Formular aplikimi për pranim në shërbimin e MZSH;
2. Fotokopje e kartës së identitetit;
3. Një kopje të jetëshkrimit(CV);
4. Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
5. Dokument zyrtar që vërteton përfundimin e arsimit;
6. Çertifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);
7. Fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit "C";
8. Certifikatë e gjendjes gjyqësore;
9. Certifikatë familjare;
10. Vërtetim nga gjykata;
11. Vërtetim nga prokuroria;
12. Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton "gjëndje të mirë shëndetsore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar";
13. Fotokopje e librezës së punës e njësuar me origjinalin;
14. Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
15. Fotografi (2.5 x 3.5 cm), 2 (dy) cope.

Dokumentat duhet të dorëzohen pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Klos brenda datës 03.05.2024.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË DOKUMENTACIONIT

Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Klos do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Klos dhe standat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohen testimet.

Kandidatët e kualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Klos. Afati i ankimit është 2 (dy) ditë nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Njohuritë mbi ligjin nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”
- VKM-së Nr.520, datë 25.7.2019 “Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët që kualifikohen për të vazhduar procesin e pranimit në shërbimin e MZSH-së u nënshtrohen fazave të konkurrimit, sipas rendit të mëposhtëm:

- a) Testim me shkrim;
- b) Testim i aftësive fizike;
- c) Intervistë me gojë;
- ç) Testimi psikologjik;
- d) Verifikim përfundimtar i aplikant

Procedura e konkurimit do të ndjekë këto faza:

- Testimi me shkrim, shërben për të vlerësuar nëse aplikanti zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë 70% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim, do të njoftohen për të vazhduar procesin e testimit të aftësive fizike.

- Testimi i aftësive fizike, teston aftësitë psiko-motore, ku përfshihen: shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca, forca muskulare dhe koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë mbi 60% të pikëve maksimale vazhdojnë procesin e testimit.

- Intervista me gojë konsiston në testimin e aftësive të aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.

- Testimi psikologjik konsiston në vlerësimin e aftësive të kandidatit për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal;

Rezultati i përgjithshëm i aplikantit përcaktohet si shumatore e rezultatit të testimit me shkrim 50% dhe rezultatit të intervistës me gojë 50%. Kandidatët fitues do të renditen sipas pikëve të marra dhe përzgjedhja e kandidateve për tu emëruar do të fillojë nga kandidati fitues që ka marë më shumë pikë.

Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Klos do të shpallë fituesit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë dhe në stendat e informimit të publikut. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Klos. Afati i ankimit është 5 ditë nga data e shpalljes së rezultateve të testimit.